Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 17 dhjetor 2010

Lënda nr. 06/07

Simo MITROVIĆ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2010, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Paul LEMMENS, kryesues
znj. Christine CHINKIN

z. Rajesh TALWAR, zyrtar ekzekutiv

Pasi vërtetuan tërheqjen e z. Marek NOWICKI nga rasti në pajtim me Rregullën 12 të Rregullores së punës,

Pasi që konsideruan ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, bën gjetjet dhe rekomandimet vijuese:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 15 shtator 2007 dhe është regjistruar më 18 tetor 2007. Në fillimin e procedurave para Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut (Paneli), ankuesi është përfaqësuar nga Praxis, një organizatë kjo joqeveritare nga Beogradi, Serbi. Më vonë OJQ-ja Praxis u tërhoq nga pjesëmarrja në rast.

2. Më 7 shkurt 2008, Paneli ia komunikoi lëndën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), duke ia dhënë atij mundësinë të jep komente në emër të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës në pajtim me Rregullën 30 të Rregullores së punës të Panelit. PSSP-ja nuk ka shfrytëzuar këtë mundësi.

3. Më 7 maj 2008, Paneli shpalli ankesën si të pranueshme.

4. Më 13 maj 2008, Paneli ia komunikoi ankesën PSSP-së në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006, me qëllim të marrjes së përgjigjes së UNMIK-ut për bazueshmërinë e rastit.

5. Më 16 shtator 2008, PSSP-ja ftoi Panelin që të kërkon informata drejtpërdrejtë nga Agjencia Kosovare e Pronave (AKP).

6. Më 17 nëntor 2008, në përgjigje të kërkesës së Panelit, AKP-ja dha dosjen e plotë të lëndës për rastin e ankuesit.

7. Në letrën e datës 20 janar 2009, PSSP-ja dha komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e rastit, duke bashkëngjitur letrën e AKP-së të datës 19 shtator 2008.

8. Më 23 janar 2009, Paneli i shkroi OJQ-së Praxis, përfaqësueses ligjore të ankuesit, ku ajo ftohej t'i parashtronte komentet në letrat e PSSP-së dhe të AKP-së.

9. Më 6 shkurt 2009, Praxis iu përgjigj Panelit, ku theksoj se më nuk ishte përfaqësuese ligjore e ankuesit. Praxis po ashtu nënvizoj se kërkesat e Panelit pas përkthimit në gjuhën serbe do t'i përcillen ankuesit në mënyrë që ai t'i jep komentet e tij.

10. Më 20 shkurt 2009, Paneli ia ofroj ankuesit letrën në gjuhën serbe.

11. Pasi që nuk morri përgjigje deri në datën e kërkuar, më 9 korrik 2009 dhe më 13 korrik 2009 Sekretaria e Panelit kontaktoi ankuesin përmes telefonit dhe ia la porosinë djalit të tij. Paneli nuk morri përgjigje në pyetjet e tij.

II. FAKTET

12. Ankuesi është banor i Kosovës që aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi. Ai thotë se më 30 dhjetor 1996 i është ndarë një banesë në komunën e Shtimes, të cilën e bleu më 19 mars 1999. Ai doli nga Kosova në qershor të vitit 1999.

13. Pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, Drejtoria Pronësore Banesore (HPD) dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (HPCC) u themeluan përmes Rregullores së

UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë pronësore banesore dhe të Komisionit për kërkesa pronësore banesore, të datës 15 nëntor 1999. Mandati i HPD-së ishte rregullimi i të drejtave banesore dhe pronësore në Kosovë dhe zgjidhja e kontesteve lidhur me pronën e banimit, derisa PSSP-ja të vendoste se gjykatat lokale janë të afta të zbatojnë këto funksione. Qëllimi ishte ofrimi i një drejtimi të përgjithshëm për të drejtat pronësore në Kosovë me qëllim të arritjes së zgjidhjes së efektshme dhe efikase të kërkesave lidhur me pronën e banimit. Përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 u themelua HPCC si një organ i pavarur i HPD-së që ishte përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve komerciale lidhur me pronën e banimit, të cilat konteste ia dërgonte HPD-ja. Rregullorja e punës dhe e dëshmive ishin subjekt i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 për kërkesat ndaj pronës së banimit dhe për Rregulloren e punës dhe të dëshmive të Drejtorisë pronësore banesore dhe të Komisionit për kërkesa pronësore banesore.

14. HPPC-ja ka juridiksion për tri kategori të kërkesave pronësore banesore: kërkesat pronësore të individëve, të drejtat e pronësisë, posedimit apo të shfrytëzimit të pronës banesore të të cilëve janë marrë pas datës 23 mars 1989 në bazë të legjislaturës që është diskriminuese në zbatimin apo qëllimin e saj (kërkesat pronësore të kategorisë "A"); kërkesat pronësore të individëve që kanë hyrë në transaksione pronësore joformale pas datës 23 mars 1989 (kërkesat pronësore të kategorisë B); dhe kërkesat pronësore nga individët që pas datës 24 mars 1999 në mënyrë të pavullnetshme kanë humbur pronësinë, posedimin apo të drejtën e shfrytëzimit të pronave të tyre.

15. Më 23 mars 2002, ankuesi parashtroi në HPD një kërkesë pronësore të kategorisë C, përmes së cilës kërkonte riposedimin e banesës së tij në Shtime. Ai argumentonte se kishte të drejtën e shfrytëzimit të banesës sipas dëshmisë, gjegjësisht vendimit të komunës së Shtimes, të datës 30 dhjetor 1996, përmes së cilit i ndahej banesa atij dhe në bazë të kontratës së blerjes, të nënshkruar më 30 nëntor 1998, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Ferizajt më 19 mars 1999. Në kopjen e kontratës së fundit nuk ceket numri referent për vërtetim nga Gjykata. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij pronësore, ankuesi pohoi se ishte vendosur në pronën në fjalë, derisa ndërtesa ende ishte në ndërtim e sipër dhe rrjedhimisht nuk ishte regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve publike.

16. Kërkesa pronësore e ankuesit është kundërshtuar nga z. N.I, i cili në atë kohë ishte vendosur në banesën kontestuese. Ai argumentonte se kishte marrë pronën ndaj banesës, duke nënshkruar kontratën e blerjes me kompaninë ndërtimore G, më 15 nëntor 2002, e cila kishte ndërtuar ndërtesën ku gjendej banesa.

17. HPD-ja tentoi t'i verifikonte dokumentet e parashtruara nga ankuesi. HPD-ja kërkoi informata edhe nga Komuna e Shtimes, si pronare e së drejtës për ndarje të banesës, me qëllim të verifikimit të vendimit fillestar për ndarjen e banesës. Mirëpo, vendimi nuk ka mundur të gjendet në arkivin e tyre. Po kështu, HPD-ja tentoi të verifikoj kontratën e blerjes në Gjykatën Komunale të Ferizajt, institucion ky që ka vërtetuar kontratën. Megjithatë, pas krahasimit me dosjet e Gjykatës, kontrata nuk ka mundur të vërtetohet se është autentike.

18. HPD-ja lëshoi vendimin e saj më 21 tetor 2005, përmes të cilit refuzonte kërkesën pronësore në bazë të asaj që ankuesi, si dhe disa ankues të tjerë në të njëjtën situatë "në rastin më të mirë, kanë paraqitur vendime të vlefshme për ndarjen e pronës së kontestuar, por nuk kanë ofruar ndonjë dokument tjetër të vërtetuar. Për më tepër, pasi që më 24 mars

1999, pronat në fjalë ishin ende në ndërtim e sipër, këta ankues asnjëherë nuk kanë hyrë në posedim të pronës në fjalë.

HPCC ka ardhur në përfundim se parashtruesit e kërkesave pronësore në fjalë "rrjedhimisht nuk kishin të drejta pronësore ndaj këtyre pronave dhe se të njëjtat nuk iu kishin marrë nga posedimi".

19. Më 24 mars 2006, ankuesi parashtroi kërkesë për rishqyrtimin e atij vendimi. Ai deklaronte se HPCC-ja kishte gabuar kur ka thënë se ai nuk kishte dorëzuar dëshmi për të drejtat e tij pronësore. Ai prapë iu referua vendimit për ndarjen e banesës të datës 30 dhjetor 1996 dhe kontratës së blerjes, të vërtetuar më 30 mars 1999. Regjistrat tregojnë se ankuesi ka dhënë edhe një kopje tjetër të kontratës së blerjes – kësaj radhe me numër të vërtetimit. Ankuesi deklaroi se ka jetuar në banesë me familjen e tij nga prilli i vitit 1998. Ai më tej shpjegon se nuk ka mundur të dorëzojë faturat e shërbimeve komunale, por ka ftuar HPCC-në t'i kontrollojë arkivat e ish-kompanisë elektroenergjetike dhe të sigurohet se ai ka shfrytëzuar rrymën elektrike. Ai në fund argumenton se vendimi përfundimtar i kësaj lënde ishte në kundërshtim me vendimet e disa shfrytëzuesve të tjerë të banesave në të njëjtën ndërtesë, të cilët ishin në të njëjtën pozitë siç ishte edhe ankuesi dhe i cili kishte dhënë dokumente të ngjashme dhe kishte marrë vendim të favorshëm nga HPCC-ja.

20. HPD-ja tentoi të verifikojë dëshmitë e dhëna nga ankuesi. HPD-ja po ashtu i pyeti fqinjët nëse ankuesi ka jetuar ndonjëherë në banesën në fjalë, por nuk mundi të gjejë askënd që do të mund të verifikonte këtë pohim. Përveç kësaj, shumë dëshmitarë thanë se ndërtesa në fjalë ishte në ndërtim e sipër që nga 24 marsi 1999. HPD-ja gjithashtu kontaktoi kompanitë e shërbimeve komunale për të parë nëse do të mund të jepnin dëshmi se a ka jetuar ndonjëherë ankuesi në pronën në fjalë. Këto kompani nuk kanë mundur të gjejnë ndonjë regjistër për të që do ta lidhte me atë pronë.

21. Më 10 tetor 2006, HPD-ja kontaktoi ankuesin dhe e pyeti nëse kishte nënshkruar kontratë të qirasë me Ndërmarrjen Publike Banesore, ankuesi u përgjigj se ai nuk kishte nënshkruar këtë kontratë, duke marrë parasysh faktin se komuna nuk kishte bërë pranimin teknik të ndërtesës, edhe pse ndërtimi kishte përfunduar. Ai më tej theksojë se ai dhe personat e tjerë ishin vendosur në banesa pa dhënien e çelësave apo pa lejen për banim, dhe përsëriti se kishte dokumente të vlefshme për banesën e tij.

22. HPCC-ja nxjerri vendimin e saj më 11 dhjetor 2006, përmes të cilit refuzohej kërkesa e ankuesit për rishqyrtim. Ai përsëriti se në bazë të nenit 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet: "a. Pas dhënies së dëshmisë relevante ligjore, e cila nuk është marrë parasysh nga [HPCC-ja] gjatë marrjes së vendimit për kërkesën; apo b. Në bazë të ekzistimit të gabimit material në zbatim të [asaj] Rregulloreje". HPCC-ja gjeti se "nuk është parë se [HPCC-ja] ka bërë ndonjë gabim në zbatimin e [Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60], e as që ka dalë ndonjë dëshmi e re që do të rezultonte me ndonjë ndryshim në vendimin e shkallës së parë të [HPCC-së]". Duke marrë parasysh se kërkesa ka ngritur një çështje specifike, HPCC-ja vazhdoi për të konsideruar si në vijim:

"Pala kërkuese, e cila është sipas vendimit fillestar është paditëse e pasuksesshme e kategorisë C, pohon se (HPCC) i mbështeti dy kërkesën e parashtruara nga dy kolegë, të

cilët gjithashtu kanë punuar në Kuvendin Komunal të Shtimes, dhe e konsideron këtë si kundërthënëse. Pala kërkuese thotë se këta kolegë kanë fituar banesat në baza të njëjta si edhe pala kërkuese. HPCC-ja ka hetuar të dy kërkesat e cekura nga pala kërkuese, dhe thekson se të dy kërkesat janë pranuar, duke u bazuar në dëshmitë e verifikuara që tregonin posedimin e ligjshëm, ndërsa pala kërkuese për lëndën në fjalë nuk dorëzojë dokumente që do të mund të verifikoheshin".

23. Vendimi për kërkesën për rishqyrtim është vërtetuar më 23 mars 2007. Ankuesi ka pranuar vendimin më 9 maj 2007.

24. Në ndërkohë, përmes Rregullores nr. 2006/10, të datës 4 mars 2007 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, është themeluar AKP-ja si një organ trashëgues i HPD-së. Megjithatë, neni 23 parashihte që HPCC-së t'i vazhdohej kompetenca për zgjidhjen e kërkesave pronësore, të cilat tanimë ishin parashtruar në HPD, dhe të veprojë ndaj kërkesave për rishqyrtim të vendimeve në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60.

25. Pak kohë më pas Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/10 ishte "pezulluar përkohësisht" përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën private të paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, të datës 16 tetor 2006. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, AKP-ja ka mbetur si organ i pavarur. Përmes nenit 22 parashihej që HPCC-ja të vazhdojë të ketë kompetencën për zgjidhjen e kërkesave që tanimë ishin dorëzuar në HPD dhe për të vepruar ndaj kërkesave për rishqyrtimin e vendimeve në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60. Në bazë të një dispozite tjetër të të njëjtit nen, Rregullorja e UNMIK-ut ka mbetur në fuqi deri më 31 dhjetor 2008.

III. Ankesa

26. Ankuesi ankohet për një numër shkeljesh të pohuara të së drejtës për zbatimin e procesit të duhur apo të së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar përmes nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj):

- Ai deklaron se HPCC-ja nuk ka marrë parasysh të gjitha dëshmitë e paraqitura, duke mos nxjerrë kështu një vendim të arsyeshëm;
- Ai po ashtu thotë se procedurat para HPCC-së kanë shkelur të drejtën e tij për vendim brenda kohës së arsyeshme;
- Ai pohon se HPCC-ja në përgjithësi nuk kishte pavarësi dhe paanësi, për shkak të mosndarjes reale të kompetencave në Kosovë dhe për shkak të mungesës së rregullave për përbërjen etnike të komisionarëve lokalë, dhe se nuk ishte një tribunal i paanshëm, pasi që vendimi për rishqyrtim është marrë nga Paneli i njëjtë, i përbërë nga anëtarët e njëjtë, të cilët kishin marrë vendimin e shkallës së parë.

27. Ankuesi më tej ankohet për faktin se HPCC-ja ka nxjerrë vendim që nuk përfillte të drejtat e tij pronësore apo së paku të drejtat e tjera relevante pronësore (të drejtën për dhënie me qira) lidhur me banesën në fjalë. Ky vendim qonte në shpronësim *de facto*. Në këtë aspekt, ankuesi thirret në shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.

28. Ankuesi gjithashtu argumenton se është parandaluar nga qasja dhe riposedimi i shtëpisë së tij dhe nga të gëzuarit e lirshëm të hapësirës së tij private. Sipas tij, UNMIK-u nuk ka mbrojtur të drejtën e tij për respektim të shtëpisë dhe jetës së tij private, dhe se HPCC-ja ka ndërhyrë në këto të drejta pa arsyetim të duhur. Në këtë drejtim, ai thirret në shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së.

29. Në fund, ankuesi thotë se mungesa e lartpërmendur e paanësisë e HPCC-së gjatë procedurave të rishqyrtimit ndikon në "efektshmërinë" e mekanizmit të HPD/HPCC-së, i cili është mjet ligjor për zgjidhjen e kontesteve pronësore-banesore. Në këtë drejtim, nuk ekziston ndonjë mekanizëm tjetër i efektshëm. Në këtë rast, ai thirret në shkeljen e nenit 13 të KEDNj-së.

IV. LIGJI

A. Shkeljet e pohuara të nenit 6 § 1 të KEDNj-së

1. *Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 të KEDNj-së*

30. Çështja bazë që Paneli duhet ta përcaktojë është nëse neni 6 § 1 i KEDNJ-së vlen për këtë rast. Në pjesën relevante të tij, neni 6 § 1 thotë:

> Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të tij qytetare apo në rastin e çfarëdo padie penale të ngritur kundër personit, ai ka të drejtë në seancë të drejtë dhe publike dëgjimore brenda një kohë të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar sipas ligjit [...].

31. Neni 6 § 1 i KEDNj-së zbatohet në përcaktimin e "të drejtave dhe obligimeve qytetare të personit". Paneli thekson se kontesti mes palëve para HPCC-së ka pasur të bëjë me të drejtat e tyre përkitazi me pronën e caktuar të banimit. Rrjedhimisht, kontesti kishte të bënte me përcaktimin e të drejtës pronësore të ankuesit, e drejtë kjo që qartazi është e natyrës "civile" (shih Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj) *Zander kundër Suedisë*, aktgjykimi i datës 25 nëntor 1993, *Publikimet e Gjykatës*, botimi A, nr. 279-B, faqe 40, § 27).

32. Neni 6 § 1 i KEDNj-së parimisht vlen vetëm për procedurat para "gjykatës". GjEDNj-ja ka deklaruar se "gjykata karakterizohet në aspektin thelbësor të fjalës përmes funksionit të saj gjyqësor, gjegjësisht me përcaktimin e çështjeve në kuadër të kompetencës së saj në bazë të sundimit të ligjit dhe pas procedurave gjyqësore, të realizuara sipas mënyrës së paraparë" (GjEDNj (Dhoma e lartë), *Qiproja kundër Turqisë*, nr. 25781/09, aktgjykimi i datës 10 maj 2001, GjEDNj, 2001-IV, § 233). Përveç kësaj, gjykata në fjalë duhet të ketë juridiksion për shqyrtimin e të gjitha aspekteve faktike dhe të ligjit që janë relevante për kontestin në fjalë (shih GjEDNj, *Ollujiq kundër Kroacisë*, nr. 22330/05, aktgjykim i datës 5 shkurt 2009, §38). Megjithatë, në mënyrë që një organ të cilësohet si "gjykatë", neni 6 § 1 i KEDNj-së nuk parasheh që "të jetë gjykatë klasike, e integruar në sistemin standard gjyqësor të vendit" (GjEDNj, *Campell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 28 qershor 1984, *Publikimet e gjykatës*, seria A, nr. 80, faqe 39 § 76).

33. Në këtë kontekst, Paneli thekson se HPCC-ja nuk ka qenë gjykatë e tipit klasik. Ky ishte një organ i procedimit të kërkesave pronësore, i cili lëshonte vendime obliguese dhe të zbatueshme (shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23, të cituar më lartë). Rregullorja e punës për procedurat para HPCC-së është përcaktuar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, ku HPCC-ja ka marrë vendime për kërkesa pronësore në kuadër të një procesi adversial në bazë të sundimit të ligjit. Këto vendime kanë qenë të formës së prerë dhe janë zbatuar nga organi administrativ, gjegjësisht nga HPD-ja. Rrjedhimisht, HPCC-ja ka pasur funksion gjyqësor dhe neni 6 i KEDNj-së vlen për procedurat para HPCC-së (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), Vuçkoviq, nr. 03/07, Mendimi i datës 13 mars 2010, § 34).

2. Përputhshmëria me nenin 6 § 1 të KEDNj-së

1. Ankesa në përgjithësi

a. Argumentet e palëve

34. Ankuesi në përgjithësi ankohet se "ndarja joekzistuese e pushtetit në Kosovë dhe mungesa e rregullave për përbërjen etnike të komisionarëve lokalë" tregojnë se HPCC-ja nuk kishte pavarësi dhe paanësi. Ai nuk elaboron në këto argumente.

35. PSSP-ja nuk jep ndonjë koment specifik në këtë pjesë të ankesës.

b. Vlerësimi i Panelit

36. Paneli vëren se kundërshtimet e ankuesit lidhur me mosekzistimin e ndarjes së pushtetit në realitet në Kosovë dhe lidhur me mungesën e rregullave për përbërjen etnike të HPCC-së janë shumë të përgjithshme për kah natyra e tyre. Ankuesi nuk thekson ndonjë arsye specifike pse ai do të duhej të dyshonte në pavarësinë dhe paanësinë e HPCC-së e as që elaboron në ato teori.

37. Paneli vjen në përfundim se kjo pjesë e ankesës nuk është arsyetuar. Rrjedhimisht, nuk mund të pranohet si e bazuar mirë.

2. Ankesa specifike

a. Argumentet e palëve

38. Në mënyrë specifike, ankuesi argumenton se HPPC-ja nuk ishte një tribunal i paanshëm për shkak se vendimet e shkallës së parë dhe ato të shkallës së dytë janë marrë nga i njëjti panel në përbërje të njëjtë.

39. Ai i referohet nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, ku thuhet se HPCC-ja "fillimisht do të përbëhet nga paneli prej dy anëtarëve ndërkombëtarë dhe një anëtari vendor" *(sic)*. Në bazë të ankuesit, ishte e qartë se legjislatori nuk kishte për qëllim që kjo situatë të zgjaste shumë vite.

40. Në nenin 25.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 ankuesi gjen shprehjen e qëllimit për themelimin e më shumë se një paneli, ku thuhet se "pas themelimit të dy apo më

shumë paneleve të Komisionit, çfarëdo shqyrtimi i lëndëve do të bëhet nga paneli tjetër, nga ai që ka marrë vendimin për kërkesën pronësore, përveç nëse kryesuesi i Panelit që emërohet për zbatimin e rishqyrtimit, në konsultim me kryetarin e Komisionit, përcakton se shqyrtimi duhet të bëhet në seancë plenare". Ai më tej i referohet qartësimit të dhënë nga PSSP-ja më datë 12 prill 2001, ku pika 21 e tij thotë se "mënyra e vetme e parashtrimit të ankesës ndaj vendimeve të HPCC-së është që ajo të bëhet pran panelit tjetër apo në seancë plenare të HPCC-së, e jo në gjykata".

41. PSSP-ja përgjigjet se në pajtim me nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, themelimi i panelit të dytë për marrjen e vendimeve rreth kërkesave pronësore në shkallën parë apo në shkallën e dytë nuk ishte obligues, por i lihej në diskrecion PSSP-së. Sasia e punës dhe financimi në dispozicion ishin të tilla që nuk mundësonin krijimin e panelit të dytë. Kështu, kërkesat për rishqyrtim me të vërtetë janë shqyrtuar nga një panel ekzistues. Paanësia e HPCC-së megjithatë nuk është rrezikuar sepse përgatitja e lëndëve është bërë nga juristë të ndryshëm. Kjo ka qenë e mjaftueshme të garantohet një shqyrtim në të gjitha lëndët.

b. Vlerësimi i Panelit

42. Sipas nenit 6 § 1 të KEDNj-së, paanësia zakonisht nënkupton mosekzistimin e paragjykimit apo të anësisë. Ekzistojnë dy teste për vlerësimin nëse tribunali është i paanshëm: testi i parë tenton të përcaktojë bindjen apo interesin personal të caktuar të vendimmarrësit për lëndën në fjalë dhe testi i dytë nënkupton vërtetimin nëse vendimmarrësi ka ofruar garanca të mjaftueshme për të përjashtuar çfarëdo dyshimi legjitim në këtë aspekt (shih, në mesin e shumë aktgjykimeve të tjera të GjEDNj-së: GjEDNj (Dhoma e lartë), *Kyprianou kundër Qipros*, nr. 73797/01, aktgjykimi i datës 15 dhjetor 2005, GjEDNj, 2005-XIII, § 118; GjEDNj (Dhoma e lartë), *Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July kundër Francës*, nr. 21279/02 dhe 36448/02, aktgjykimi i datës 22 tetor 2007, § 75).

43. Për lëndën në fjalë, ankuesi ankohet vetëm për paanësinë e pohuar strukturore të HPCC-së. Rrjedhimisht, duhet të zbatohet testi i dytë.

44. Sa i përket këtij testi, kur aplikohet për një trup siç është paneli, do të thotë përcaktimi, pavarësisht nga sjellja personale e cilitdo anëtar i atij organi, nëse ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrisin dyshime për paanësinë e tij. Në këtë drejtim, edhe dukja mund të jetë e rëndësishme. Kjo pasohet me atë se kur vendoset nëse në ndonjë lëndë të caktuar ka arsye legjitime për frikë se organi i caktuar ka mungesë të paanësisë, pikëpamja e tyre që thonë se është i paanshëm, është e rëndësishme, por jo edhe vendimtare. Ajo që është vendimtare është nëse kjo frikë mund të konsiderohet si objektivisht e arsyeshme (GjEDNj (Dhoma e lartë) *Kyprianou kundër Qipros*, e cituar më lartë, § 118; GjEDNj (Dhoma e lartë) *Lindon, Otchakovsky-Laurens dhe July kundër Francës*, cituar më lartë, § 77).

45. Paneli vëren se në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, pjesëmarrja në procedurat e apelit e gjyqtarëve, të cilët kanë shqyrtuar lëndë në shkallën e parë mund të përbëjë shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së (GjEDNj, *Oberschlick kundër Austrisë (nr.1)*, aktgjykim i datës 23 maj 1991, *Publikimet e Gjykatës*, Seria A, nr.

204, faqe 23, § 51). E njëjta vlen edhe me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procedurat "kundërshtare", të drejtuara kundër bazueshmërisë së vendimeve, ku ata vet kanë marrë pjesë (GjEDNj, *De Haan kundër Holandës*, aktgjykimi i datës 26 gusht 1997, *Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-IV, pp. 1392-1393, § 51).

46. Në bazë të nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, HPCC-ja "fillimisht do të përbëhet prej një paneli prej dy anëtarëve ndërkombëtarë dhe një anëtari vendor, ku të gjithë ata do të jenë ekspertë në fushën e të drejtës pronësore-banesore dhe do të jenë kompetent për të mbajtur poste gjyqësore" (sic). Neni 22 gjithashtu parasheh që PSSP-ja "mund të themelojë panele shtesë të [HPCC-së] në konsultim me [HPCC-në]". Në praktikë, nuk janë themeluar panele shtesë. Rrjedhimisht del se kërkesat për rishqyrtim do të mund të shqyrtohen nga paneli i njëjtë dhe me përbërje të njënjë me panelin që ka lëshuar vendimin për rishqyrtim. Kjo ka ndodhur në rastin e ankuesit.

47. Paneli pranon që një situatë e tillë do të mund të ngriste dyshime në mendjen e ankuesit lidhur me paanësinë e panelit të HPCC-së gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij për rishqyrtim. Megjithatë, Paneli duhet që më tej të vlerësojë nëse ato dyshime janë arsyetuar në mënyrë objektive (konsultoni GjEDNj, *Morel kundër Francës*, nr. 34130/96, aktgjykimi i datës 6 qershor 2000, GjEDNj, 2000-VI, § 44).

48. Në këtë aspekt, natyra e procedurave për rishqyrtim duhet të merret parasysh. Paneli përkujton se neni 14.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 i ka mundësuar cilësdo palë në proces që të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim, duke u bazuar në: "a) paraqitjen e dëshmive relevante ligjore, të cilat nuk janë marrë parasysh nga [HPCC-ja] gjatë marrjes së vendimit për kërkesën pronësore apo "b) në bazë të asaj se ka pasur gabim material në zbatimin e kësaj Rregulloreje". Derisa arsyeja e parë dukej se kufizonte mundësinë për kryerjen e rishqyrtimit vetëm në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, arsyeja e dytë kishte efektin e bërjes së kërkesës analoge me ankesë sa i përket ligjit dhe fakteve. Bazat e gjëra për zbatimin e rishqyrtimit janë të parapara në nenin 25.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, në bazë të së cilës,

"[i] gjatë rishqyrtimit të vendimit, [HPCC-ja] apo Paneli, i themeluar nga ai, merr parasysh të gjitha dëshmitë dhe përfaqësimet e parashtruara lidhur me kërkesën fillestare pronësore dhe çfarëdo dëshmie a përfaqësim të ri përkitazi me kërkesën për rishqyrtim. [HPCC-ja] apo Paneli përgjegjës e refuzojnë kërkesën për rishqyrtim apo nxjerrin vendim të ri për kërkesën pronësore".

49. Obligimi i HPCC-së për të shqyrtuar jo vetëm dëshmitë e reja, por edhe dëshmitë tanimë të parashtruara tek ai gjatë procedurës fillestare, konfirmon se kërkesa për rishqyrtim nuk mund të konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm ligjor. Në këtë aspekt, Paneli ka mendim tjetër nga ai i shprehur në vendimin e tij për bazueshmëri në lëndën 43/08, *Simiq* (vendimi i 12 dhjetorit 2008, § 14).

50. Lidhur me lëndën në fjalë, në kërkesën e tij për rishqyrtim ankuesi në thelb argumenton se HPCC-ja ka vlerësuar gabimisht elementet e lëndës. Në bazë të ankuesit, ai ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme se kishte të drejta të caktuara në banesë dhe se ka mënyra për të verifikuar se ka jetuar në banesë para se të shkonte nga Kosova. Si një provë tjetër për gabimin e madh të bërë nga HPCC-ja ai iu referua rasteve të personave të

tjerë që pohojë se kanë qenë në situatë të njëjtë, ku HPCC-ja kishte mbështetur të drejtat e tyre pronësore.

51. HPPC-ja erdhi në vendimin e tij për rishqyrtim pas analizës më të fundit të dëshmive në dispozicion dhe pas tentimeve të reja për verifikimin e dokumenteve të parashtruara, si dhe pas pohimeve të bëra nga ankuesi. HPCC-ja erdhi në përfundim se nuk është bërë asnjë gabim, se nuk është sjellë ndonjë dëshmi e cila do të rezultonte me ndryshim të vendimit të tij dhe se rasti i ankuesit dallohej nga rastet e personave që ai kishte përmendur.

52. Rrjedhimisht, duket se HPCC-ja në fakt është ftuar që t'i shikojë edhe njëherë elementet e lëndës dhe se në fakt HPCC-ja edhe e ka bërë këtë. Pra, nuk e kufizojë shqyrtimin e tij vetëm në dëshmitë e reja.

53. Paneli thekson se në bazë të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, në rastet kur të njëjtit gjyqtarë ftohen për të përcaktuar nëse në vendimin e tyre të mëhershëm ata vet kanë bërë "gabim të interpretimit ose zbatimit juridik" apo jo, nga ata në fakt kërkohet "që të gjykojnë vetveten dhe aftësinë e tyre për zbatimin e ligjit". Një situatë e tillë mjafton për të pasur frikë nga mungesa e paanësisë së gjyqit dhe që ajo të jetë objektivisht e arsyetueshme (GjEDNj, *San Leonard Band Club kundër Maltës*, nr. 77562/01, aktgjykim i datës 29 korrik 2004, GjEDNj, 2004-IX, § 63; në të njëjtin kuptim, GjEDNj, *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, aktgjykim i datës 13 nëntor 2007, § 81).

54. Sipas nenit 6 § 1 të KEDNj-së del se HPCC-ja nuk ka qenë e paanshme me rastin e ekzaminimit të kërkesës për rishqyrtim.

55. Rrethana ku procedura fillestare dhe procedura për rishqyrtim e lëndës është përgatitur për HPCC-në nga juristë të ndryshëm të HPD-së nuk e ndryshon këtë konkludim. Ajo që merret parasysh janë dyshimet që përbërja e panelit të HPCC-së, si organ vendimmarrës, mund t'i ngritë lidhur me paanësinë e tij.

56. Paneli thekson se kjo gjendje në ndërkohë është trajtuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10, kërkesa për rishqyrtim është zëvendësuar me ankesë drejtuar Gjykatës Supreme në bazë të asaj se "(a) vendimi paraqet shkelje të rëndë të ligjit në fuqi" apo b) vendimi bazohet në fakte jo të plota ose në vlerësimin e gabueshëm të fakteve" (neni 13.1). Kjo mundësi ka mbetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/40, e paraqitur paksa më ndryshe: sipas rregullores së fundit, ankesa mund të parashtrohet në bazë të asaj që "(a) vendimi përmban gabim bazik apo keqzbatim të rëndë të ligjit material ose procedural në fuqi" apo (b) vendimi bazohet në përcaktimin e gabueshëm ose jo të plotë të fakteve" (neni 12.3).

57. Për arsyet e lartëpërmedura, Paneli vjen në përfundim se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së lidhur me paanësinë e HPCC-së gjatë procedurës së rishqyrtimit.

ii. Drejtësia e procedurës

a. Argumentet e palëve

58. Në përgjithësi, ankuesi argumenton se me rastin e nxjerrjes së vendimit të shkallës së dytë, HPCC-ja nuk ka marrë parasysh "të gjitha dëshmitë e paraqitura dhe të nevojshme". Ai argumenton se tribunali ka për detyrë ta bëjë shqyrtimin e duhur të parashtresave, argumenteve dhe dëshmive të dhëna nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e tij nëse ato janë relevante për vendimin e tij apo jo. Ai i referohet një numri të mangësive të pohuara në mënyrën se si HPCC ka analizuar dhe elaboruar çështjet e pronësisë dhe të posedimit ligjor, si dhe argumenton se këto mangësi kanë ndikuar në drejtësinë e tërë procedurës.

59. Mangësia e parë ka të bëjë me mungesën e pohuar të shqyrtimit të të gjitha dëshmive të disponueshme. Në mënyrë specifike, ankuesi pretendon se HPCC-ja nuk ka arritur t'i marrë dëshmitë nga personat e tjerë që kanë jetuar në atë ndërtesë. Këto dëshmi do të mund të vërtetonin elementin faktik të posedimit të ligjshëm të banesës nga ankuesi. Meqë ankuesi nuk ka qenë në gjendje të jep deklaratë në cilësinë e dëshmitarit, HPCC-ja është dashur t'i shfrytëzojë autoritetet hetuese, të parapara në nenet 10.2 dhe 21.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, si dhe t'i sigurojë këto deklarata, kryesisht nga ankuesit e tjerë që kanë qenë të suksesshëm në ankesat e tyre lidhur me banesat në të njëjtën ndërtesë dhe të cilët kanë pasur rrethana materiale dhe kohore identike.

60. Mangësia e dytë ka të bëjë me vendimin e vërtetësisë së vendimit për ndarjen e banesës, të paraqitur nga ankuesi. Ankuesi pohon se përmes vendimit të dytë, HPCC-ja ka refuzuar pjesën e vendimit të shkallës së parë, i cili më parë kishte vërtetuar vlefshmërinë juridike të vendimit për ndarjen e banesës. Gjatë rishqyrtimit të vendimit, HPCC-ja ka konsideruar se as kontrata për shitblerje dhe as vendimi për ndarjen e banesës nuk mund të verifikohen për vërtetësinë e tyre. Sipas ankuesit, fakti që HPCC-ja e ka vënë atë në një situatë më të keqe se në procedurën e shkallës së parë, HPCC-ja ka shkelur parimin juridik ndalimit të *ex officio reformatio in peius*, që ka qenë element përbërës i procedurës së drejtë gjyqësore. Gjithashtu, pohohet se HPCC-ja nuk ka ofruar asnjë shpjegim për rezultatin e ndryshëm gjatë procedurës së dytë, duke mos e dhënë kështu një vendim të arsyetuar.

61. Mangësia e tretë ka të bëjë me vendimin për vërtetësinë e kontratës për shitblerje, të paraqitur nga ankuesi. Ankuesi pohon se ai ka dorëzuar një kontratë që ka qenë e vërtetuar më 19 mars 1999 nga Gjykata Komunale e Ferizajt, arkivat e së cilës janë mbajtur në Serbi që nga tërheqja e pushtetit serb nga Kosova. HPCC-ja nuk i ka besuar kësaj dëshmie, dhe ka ritheksuar se ka qenë e pamundur të vërtetohet vërtetësia e kontratës. Megjithatë, HPCC-ja nuk ka arritur të jep një shpjegim të hollësishëm të metodës së saktë të vërtetimit që përdoret nga HPCC-ja.

62. Në fund, mangësia e katërt ka të bëjë me mungesën e përdorimit të një metode alternative, të disponueshme për verifikim. Ankuesi pohon se HPCC-ja ka pasur mundësi të verifikojë vërtetësinë e vendimeve për ndarjen e banesave dhe të kontratave për blerje në rastin e dy kolegëve të tij. Meqë dokumentet e tij ishin të të njëjtit lloj sikurse ato të kolegëve të tij, një krahasim i thjeshtë i dokumenteve në të tri rastet do të kishte mjaftuar për verifikimin edhe të dokumenteve të tij. Kjo mbështetet edhe nga fakti sepse sipas nenit 22.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, HPCC-ja bazohet në parimet e përcaktuara në vendimet e veta në rast të zbatimit të ligjit për ankesat që ngrisin çështje të ngjashme juridike dhe të dëshmive. Sidoqoftë, në rast se një metodë e verifikimit është përdorur në dy raste të mëparshme, të cilat kanë pasur ngjashmëri, që kanë rezultuar në

vendime pozitive për ankuesit, ajo metodë është dashur të zbatohet dhe të elaborohoet në rastin e ankuesit. Ankuesi pohon se mosmarrja parasysh e të gjitha fakteve materiale të disponueshme dëshmon se HPCC-ja gjatë ushtrimit të kompetencave të veta diskrecionale ka zbatuar parimet juridike dhe të dëshmive në mënyrë jokonsistente, duke rezultuar kështu me arbitraritet në procesin e vendimmarrjes.

63. Ndaj pohimit se HPCC-ja nuk ka vlerësuar dëshmitë në mënyrë në duhur, PSSP-ja përgjigjet në mënyrë të përgjithësuar. Në bazë të shikimit të dosjes së HPD-së nga AKP-ja, ai vëren se gjatë procedurës së shkallës së parë, kontrata e blerjes nuk ka mundur të verifikohet se është autentike në krahasim me dosjet e Gjykatës Komunale të Ferizajt. Në mungesë të ndonjë dokumenti tjetër që do të dëshmonte posedimin e pronës para datës 24 mars 1999, dhe duke qenë se vetëm vendimi për ndarjen e banesës nuk është i mjaftueshëm, si dhe në dritën e faktit se ndërtimi është kryer pas asaj date, HPCC-ja erdhi në përfundim se ankuesi nuk kishte të drejtën e pronës. Gjatë procedurës së rishqyrtimit, HPD-ja bëri përpjekje të tjera për të përcaktuar ekzistencën e të drejtës së pohuar pronësore të ankuesit. HPD-ja kontaktoi banorët e banesave fqinje dhe të kompanive të ndryshme komunale, por nuk ka mundur të merr ndonjë informatë që do të mbështeste pohimin e ankuesit. Në fakt, ishte e kundërta, dëshmitari vërtetoi se ndërtesa ishte ende në ndërtim e sipër gjatë kohës në fjalë. Për më tepër, në një intervistë telefonike me HPD-në, më datën 10 tetor 2006, ankuesi deklaroi se kurrë nuk kishte nënshkruar kontratë të qiramarrjes me ndërmarrjen publike të banimit. Pa një kontratë të tillë, ai nuk do të mund të blinte pronën në mënyrë të ligjshme. Në mungesë të çfarëdo dokumentacioni mbështetës nga ankuesi dhe përkundër përpjekjeve nga HPD-ja për të sjellë dëshmi të tjera (në pajtim me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60), HPCC-ja refuzoi kërkesën për rishqyrtim.

b. Vlerësimi i Panelit

64. Siç cek me të drejtë ankuesi, neni 6 § 1 i KEDNj-së parasheh përgjegjësinë që tribunali të bëjë një shqyrtim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe dëshmive të dhëna nga palët (shih, *p.sh*. GjEDNj, *van de Hurk kundër Holandës*,aktgjykimi i datës 19 prill 1994, Publikimet e Gjykatës, Seria A, nr. 288, faqe 19, § 59).

65. Megjithatë, nuk është detyrë e Panelit që të veprojë si gjykatë apeli ndaj vendimeve të HPCC-së (shih përshtatshmërisht, Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), *Todoroviq*, nr. 33/08, vendim i datës 17 prill 2009, § 21, shih gjithashtu PKDNj, *Parliq*, nr. 01/7, Mendimi i datës 18 qershor 2010, § 35). Roli i HPCC-së është që të interpretojë dhe të zbatojë rregullat përkatëse të së drejtës materiale apo procedurale në procesin e vet të vendimmarrjes. Gjithashtu, HPCC-ja ka pozitën më të mirë për vlerësimin e kredibilitetit të dëshmisë dhe të relevancës së saj për çështjet e lëndës (krahasoni, p.sh GjEDNj, *Vidal kundër Belgjikës*, aktgjykimi i datës 22 prill 1992, Botimet e Gjykatës, Seria A, nr. 235-B, faqe 32, § 33; GjEDNj, *Shalimov kundër Ukrainës*, nr. 20808/02, aktgjykimi i datës 4 mars 2010, § 67). Vetëm fakti se njëra palë është e pakënaqur me rezultatet e procedurës nuk mund të ngrisë çështje sipas nenit 6, § 1 të KEDNj-së (GjEDNj, *Tengerakis kundër Qipros*, nr. 35698/03, aktgjykimi i datës 9 nëntor 2006, § 74). Një vendim i tillë i tribunalit do të ishte tregues i një shkeljeje të kushteve për gjykim të drejtë nëse p.sh. paarsyeshmëria e tij është aq e dukshme saqë

vendimi mund të konsiderohet si vendim tejmase arbitrar (shih GjEDNj, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. 72118/01, aktgjykimi i datës 15 nëntor 2007, § 175.

66. Për aq sa ankuesi thotë se HPCC-ja nuk ka arritur të marrë deklarata përkatëse nga dëshmitarët, është e qartë nga dosja e HPD-së se HPCC-ja ka kërkuar të marrë dëshmitë përkatëse nga dëshmitarët (shih § 20 më lartë). Rrjedhimisht, pohimi i ankuesit nuk është i saktë nga aspekti faktik.

67. Për aq sa ankuesi thotë se HPCC-ja me rastin e rishqyrtimit ka refuzuar pjesën e vendimit të tij të shkallës së parë, përmes të cilit ishte vërtetuar vlefshmëria ligjore e vendimit për ndarjen e banesës, Paneli konsideron se nevojitet leximi i kujdesshëm i arsyeve të vendimit fillestar dhe të vendimit për rishqyrtim.

68. Në vendimin e parë të datës 21 tetor 2005, në përgjithësi HPCC-ja konsiderojë se "për të plotësuar kushtin për kërkesë të vlefshme pronësore të kategorisë C, ankuesi duhet të tregojë se ai ka humbur posedimin të pronës në fjalë. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës që nuk është në gjendje të tregojë se ai ka pasur në posedim ndonjëherë pronën në fjalë apo të drejtën e pronësisë, përmes së cilës jepej e drejta për të marrë pronën në posedim, nuk mund të ketë sukses në kërkesën e tij" (§ 13). Për sa i përket grupit të kërkesave, të cilit i përket edhe kërkesa e ankuesit, HPCC-ja konsideroi se parashtruesit e kërkesës "në rastin më të mirë" kanë paraqitur vendimet e vlefshme për ndarjen e pronës së kontestuar, "por nuk kanë dhënë ndonjë dokumentacion tjetër të verifikuar". Po kështu, pasi që më 24 mars 1999 pronat e kontestuara ishin ende në ndërtim e sipër, këta parashtrues të kërkesës "asnjëherë nuk kanë hyrë në posedim të pronave të kërkuara". HPCC-ja konkludoi se parashtruesit e lartpërmendur të kërkesës "rrjedhimisht nuk kishin të drejtë prone lidhur me pronat dhe se nuk ishin të shpronësuar prej tyre" (§ 15).

69. Në vendimin e tij të datës 11 dhjetor 2006 lidhur me rishqyrtimin, HPCC-ja thekson se ankuesi ka thënë se ka pasur kundërshtim mes vendimit të HPCC-së në rastet e dy kolegëve, të cilët gjithashtu kanë punuar në Kuvendin Komunal të Shtimes, dhe vendimit për rastin e ankuesit. HPCC-ja hedh poshtë këtë argument me arsyetimin se dy kërkesat e cekura nga ankuesi janë pranuar në bazë të dëshmisë së verifikuar "që tregon posedimin e ligjshëm", ndërsa ankuesi nuk ka paraqitur dokumente që do të mund të verifikoheshin (§10).

70. Nga kjo del se në të dy rastet çështja vendimtare për HPCC-në ishte nëse ankuesi mund të dëshmojë që ai ishte në posedim të ligjshëm të banesës më datën 24 mars 1999. Në kundërshtim të argumentit të ankuesit, HPCC-ja nuk ka konfirmuar vlefshmërinë e vendimit për ndarjen e banesës në vendimin e tij të parë. HPCC-ja e ka lënë këtë çështje të hapur, meqë edhe një vendim i vlefshëm për ndarjen e banesës nuk do të mjaftonte për të dëshmuar posedimin e pronës në fjalë. Në vendimin e tij për rishqyrtim, HPCC-ja prapë nuk ka bërë asnjë deklaratë përkitazi me vlefshmërinë e vendimit për ndarjen e banesës, por thjeshtë ka konfirmuar se ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dokument të verifikueshëm që do të tregonte posedimin e ligjshëm. Kështu që, në të dy vendimet theksohet se ankuesi nuk ka dëshmuar posedimin e banesës, pa shprehur ndonjë mendim lidhur me vlefshmërinë e vendimit për ndarjen e banesës. Andaj, argumenti i bazuar në situatën e pretenduar përkeqësuese të ankuesit në fazën e rishqyrtimit ka mungesë të bazës faktike.

71. Përderisa ankuesi argumenton se HPCC-ja nuk e konsideron të besueshme kontratën e blerjes që ai ka dorëzuar, pa shpjeguar metodën e verifikimit që është përdorur nga HPCC-ja për të arritur në atë përfundim, Paneli thekson se, sikur në rastin e vendimit të parë, vendimi për rishqyrtim në të vërtetë nuk shpjegon se pse kontrata nuk ka mundur të verifikohet. Kjo rrethanë ngritë pyetjen nëse vendimi mund të konsiderohet si i arsyetuar mjaftueshmërisht.

72. Në këtë aspekt, Paneli i referohet lëndës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, në bazë të së cilës, në përputhje me "parimin e lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet në mënyrë të duhur të cekin arsyet, në të cilat bazohen". Megjithatë "shkalla në të cilën aplikohet kjo detyrë për të dhënë arsye mund të ndryshojë në bazë të natyrës së vendimit, dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit" (GjEDNj (Dhoma e Lartë), *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, aktgjykimi i datës 21 janar 1999, GjEDNj, 1999-I, § 26). Paneli konsideron se në procedurat e parapara në mënyrë specifike për shqyrtimin e kërkesave në masë, siç është rasti i atyre të HPCC-së, detyra për dhënien e arsyeve nuk mund të kuptohet në të njëjtën mënyrë siç do duhej kuptuar në procedurat e rregullta para gjykatave të rregullta. Nuk është detyrë e Panelit që të elaborojë teorinë e përgjithshme për këtë çështje. Paneli kufizohet në theksimin se me rastin e procedurave të kërkesave në masë, siç janë ato të HPCC-së nga pikëpamja e drejtësisë së procedurave, mund të jetë e mjaftueshme që vendimi i tribunalit të tregojë në aspekte të përgjithshme arsyen pse një kërkesë pronësore pranohet apo refuzohet, pa iu referuar shprehimisht elementeve konkrete të rastit të caktuar, me kusht që arsyetimi i tij të gjejë mbështetje tek elementet e dosjes. Nuk është detyrë e Panelit të verifikojë nëse një përkrahje e tillë me të vërtetë mund të gjendet.

73. Nga Raporti për procedimin e kërkesave gjatë procedurës së parë, të hartuar nga zyrtari ligjor i HPD-së, rezulton se kontrata e blerjes e parashtruar nga ankuesi nuk ka mundur të verifikohet se është autentike gjatë krahasimit me dosjet e Gjykatës Komunale të Ferizajt, e cila pohohet të ketë vërtetuar kontratën më 19 mars 1999. Në atë kopje të kontratës nuk ka pasur numër të vërtetimit. Kur ankuesi parashtroi kërkesë për rishqyrtim, kërkesës së tij ai i shtoi edhe kopjen tjetër të kontratës së njëjtë, por kësaj radhe me numër të plotësuar në hapësirën e paraparë për të në formulën e vërtetimit. Raporti për procedimin e kërkesës, i përpiluar nga një zyrtar tjetër ligjor i HPD-së, tregon se ky numër nuk është vërejtur: në raport thuhet se ankuesi ka parashtruar "kopje identike" "pa numër të vërtetimit".

74. Megjithatë, ashtu siç ceket nga PSSP-ja në komentet e tij, hulumtimet në dosjet e kompanive të ndryshme të shërbimeve komunale dhe intervistat me fqinjët nuk kanë rezultuar me ndonjë dëshmi të posedimit, në kuptim të banimit të efektshëm në banesë. Po ashtu, më 10 tetor 2006, zyrtari ligjor i HPD-së ka pasur një intervistë telefonike me ankuesin, gjatë së cilës ankuesi deklaroi se ai asnjëherë nuk kishte nënshkruar kontratë për shfrytëzim apo qiramarrje me Ndërmarrjen Publike të Banimit. Në raportin për procedimin e kërkesës thuhet se pa një kontratë të tillë ankuesi nuk ka mundur ligjërisht të blejë pronën. Në raport gjithashtu vihet në përfundim se ankuesi nuk ishte pronar, mbajtës i së drejtës në posedim apo pronar i ligjshëm i banesës në fjalë.

75. Këto elemente të fundit mjaftojnë që formalisht të mbështesin gjetjet e HPCC-së që ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë dokument që do të tregonte posedimin e ligjshëm, i cili do të mund të vërtetohej. Gabimi lidhur me vërtetueshmërinë e kontratës së blerjes (shih më lartë, § 73) rrjedhimisht ka të bëjë me elementin që duke marrë parasysh mungesën e kontratës për shfrytëzim apo qiramarrje nuk ishte thelbësor për konkludimin e HPCC-së. Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se ky gabim nuk ndikon në rregullsinë e arsyetimit.

76. Lidhur me atë se ankuesi thotë se HPCC-ja ka mundur të vërtetojë autenticitetin e dokumenteve në dispozicion, duke i krahasuar ato me dokumentet e parashtruara nga kolegët e tij që kanë qenë të suksesshëm në kërkesat e tyre, pikësëpari Paneli thekson se kjo ankesë prapë është e drejtuar kundër një elementi që nuk është thelbësor për konkludimin e HPCC-së, duke marrë parasysh gjetjet e HPCC-së lidhur me mungesën e dëshmive për banimin e efektshëm në banesë dhe mosekzistimin e kontratës për shfrytëzim apo qiramarrje. Për më tepër, vlerësimi i dëshmive është çështje e HPCC-së, dhe nuk është përgjegjësi e Panelit të shqyrtojë vlerësime të tilla, përveç nëse ekziston ndonjë indikacion se HPCC-ja ka ardhur deri te konkludimet tepër të padrejta apo arbitrare në bazë të fakteve që i ka pasur para vetës (GjEDNj, *Herbst kundër Gjermanisë*, nr. 20027/02, aktgjykimi i datës 11 janar 2007, § 83). Në bazë të elementeve të dosjes, Paneli nuk mund të gjejë ndonjë indikacion të arbitraritetit lidhur me metodën e verifikimit të HPCC-së.

77. Si përfundim, Paneli konsideron se marrë në përgjithësi, procedurat e rishqyrtimit kanë qenë të drejta. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenin 6 § 1 të KEDNj-së.

iii. Koha e arsyeshme

a. Argumentet e palëve

78. Ankuesi thotë se periudha më shumë se pesëvjeçare mes parashtrimit të kërkesës së tij në prill të vitit 2002 dhe marrja e vendimit përfundimtar në dhjetor të vitit 2006 ngërthen shkelje të kërkesës për kohën e arsyeshme, të paraparë me nenin 6 § 1 të KEDNj-së. Ai më tej shton se rasti nuk është aq i ndërlikuar dhe se sjellja e palëve nuk i ka kontribuar vonesës. Për më tepër, edhe pse ankuesi si person i zhvendosur ka jetuar në rrethana të vështira, autoritetet nuk e kanë parë të rëndësishme për ta marrë parasysh gjendjen e tij të vështirë materiale si një shtytje për zgjidhjen e rastit të tij brenda kohës së arsyeshme.

79. Ankuesi është në dijeni për karakterin e jashtëzakonshëm të procesit të zgjidhjes së numrit të madh të kërkesave, të zbatuar nga autoritetet në Kosovë. Megjithatë ai thotë se duhet të gjendet një baraspeshë mes kërkesave për menaxhim të efektshëm të një numri të madh të lëndëve dhe të imperativit për respektimin e thelbit të të drejtave të njeriut të parashtruesve të kërkesave veç e veç, për të cilët fundja ky mekanizëm edhe është themeluar, ku e drejta për marrjen e vendimit gjyqësor brenda kohës së arsyeshme është njëra prej këtyre të drejtave. Numri i lëndëve të pazgjidhura apo dëshira e tribunalit për të dëgjuar së bashku lëndët që ngrisin çështje të ngjashme nuk mund të arsyetojë vonesat e paarsyeshme.

80. Duke iu referuar vlerësimit për kohëzgjatjen e procedurës në AKP, PSSP-ja thekson se gjatë viteve të tij të para të punës, HPD-ja përjetoi probleme domethënëse institucionale. Në veçanti, HPD-ja pati probleme financiare dhe ndërrime menaxheriale, të cilat fatkeqësisht çuan në disa vonesa për të gjitha lëndët. Ai më tej thekson se ankesa iu nënshtrua sistemit të ndërlikuar të procedimit para se t'i dërgohej HPCC-së për marrjen e vendimit, duke përfshirë këtu edhe njoftimin e banuesit aktual dhe cilëndo psalë tjetër me interes ligjor, dhe dhënien e kohës që ata të përgjigjen. Përveç kësaj, procesi i vërtetimit të dokumentacionit të parashtruar si mbështetje për kërkesën ka mundur të merr kohë.

81. Sa i përket kronologjisë së historikut të kërkesës së ankuesit. PSSP-ja thekson se e vetmja vonesë thelbësore ka ndodhur mes prillit 2002 deri në tetor 2005, dhe se kjo vonesë mund të shpjegohet përmes arsyeve të cekura më lartë.

b. Vlerësimi i Panelit

82. Procedura ka filluar më 21 mars 2002, kur ankuesi parashtroi kërkesën e tij në HPCC. Mirëpo, periudha që duhet të merret parasysh fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit, e që është 23 prill 2005. Në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës së kaluar pas datës 23 prill 2005, Paneli megjithatë do të merr parasysh gjendjen e procedurës në atë moment (GjEDNj, *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 1982, *Publikimet e gjykatës*, Seria A, nr. 56, faqe 15, § 53; GjEDNj, *Styranowski kundër Polonisë*, aktgjykimi i datës 30 tetor 1998, *Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1998-VIII, faqe 3376, § 46).

83. Paneli më tej thekson se procedura ka përfunduar më 9 maj 2007, kur ankuesi mori vendimin për rishqyrtim, më 11 dhjetor 2006.

84. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjithëmbarshme e procedurës ka qenë pesë vjet, një muaj e tetëmbëdhjetë ditë, nga të cilat dy vjet e gjashtëmbëdhjetë ditë ka zgjatur shqyrtimi nga Paneli.

85. Paneli përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke iu referuar kritereve vijuese: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e ankuesit dhe autoritetet relevante, si dhe çka rrezikohej për ankuesin në këtë kontest (shih në mesin e shumë autoriteteve të tjera, GjEDNj (Dhoma e lartë), *Frydlender kundër Francës* nr. 30979/96, aktgjykimi i datës 27 qershor 2000, GjEDNj, 2000-VII, § 43; shih gjithashtu PKDNj, nr. 17/08, *Emini*, Mendimi i datës 18 qershor 2010, § 21).

86. Paneli pranon se rasti ka qenë mjaft i ndërlikuar, posaçërisht gjatë fazës së rishqyrtimit, pasi që është dashur të merren informata nga kompanitë e shërbimeve komunale dhe deklarata nga dëshmitarët. Megjithatë, çështjet e trajtuara në këtë rast në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të jashtëzakonshme.

87. Paneli po kështu thekson se ankuesi nuk ka kontribouar në asnjë vonesë të procedurës.

88. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, Paneli vëren se ka pasur vonesë të konsiderueshme në procedurën e parë mes ditës kur i padituri z. N.I, bëri deklaratën lidhur me ankesën (27 nëntor 2002) dhe ditës kur ankuesi është kontaktuar përmes telefonit me arsye të marrjes së informatave shtesë (15 maj 2005). Një pjesë e madhe e kësaj periudhe mbetet jashtë

juridiksionit të Panelit. Pas datës së fundit, procedurat e para kanë vazhduar pa vonesa të mëdha; Raporti i procedimit të kërkesës është nënshkruar më 4 gusht 2005; vendimi i parë është nxjerrë më 21 tetor 2005 dhe është vërtetuar më 5 dhjetor 2005; ankuesi është informuar për vendimin më 12 janar 2006, ndërsa vendimi i është dërguar atij më 16 mars 2006. Pasi që zyra e HPD-së në Beograd mori kërkesën për rishqyrtim (më 24 mars 2006), HPD-ja kontaktoi fqinjët për marrjen e deklaratave të tyre në cilësinë e dëshmitarëve më 8 qershor 2006, njoftoi të padituri për kërkesën më 15 shtator 2006, kontaktoi ankuesin përmes telefonit për marrjen e informatave të tjera më 10 tetor 2006 dhe dërgoi Raportin për procedimin e kërkesës më 27 tetor 2006. HPCC-ja mori vendimin më 11 dhjetor 2006, i cili i vërtetua më 23 mars 2007 dhe iu dërgua ankuesit më 7 maj 2007.

89. Duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të pranuara nga HPD-ja, për të cilat HPPC-ja[1] duhet të nxjerrë vendim dhe vështirësitë logjistike në kontekstin e Kosovës së pasluftës, në dritën e të gjitha rrethanave të rastit, Paneli konsideron se koha e arsyeshme nuk është tejkaluar.

90. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së në këtë aspekt.

B. Shkelja e pohuar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së

1. Argumentet e palëve

91. Ankuesi thotë se edhe nëse e drejta e tij e pohuar pronësore do të mund të kontestohej, ai gjithsesi kishte të drejta të tjera relevante pronësore, të përcaktueshme në bazë të të gjitha dëshmive në dispozicion. Ai thotë se HPCC-ja ka marrë vendim, ku ka shpërfillur bazën legjitime të kërkesës së ankuesit dhe në fakt ka shuar të drejtat e tij në banesë, që *de fakto* është e barabartë me shpronësim. Pasi që një akt i tillë nuk ka mundur të arsyetohet përmes asnjë arsyeje me interes publik, ka pasur shkelje të së drejtës së tij në pronë, të garantuar përmes nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së.

92. PSSP-ja nuk jep komente specifike në këtë pjesë të ankesës.

2. Vlerësimi i Panelit

93. Paneli thekson se në këtë rast shtrohet çështja se a është i zbatueshëm neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj-së. Koncepti i "pronave" i cekur në fjalinë e parë të paragrafit të parë të asaj dispozite ka një domethënie të mëvetësishme. Ashtu siç ka vendosur në shumë raste Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, neni 1 i Protokollit 1 vlen vetëm për pronat ekzistuese të personit. Është e vërtetë se në rrethanat ekzistuese, "pritja legjitime" për marrjen e një "pasurie", gjithashtu mund të gëzojë mbrojtjen përmes nenit 1 të Protokollit 1, me kusht që të ketë bazë të mjaftueshme në ligjin në fuqi përkitazi me interesin e pronësor, për shembull, kur kemi një rast të zgjidhur gjyqësor në gjykatat vendore, kur konfirmohet ekzistenca e këtij interesi (GjEDNj (Dhoma e lartë), *Kopecky kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, GjEDNj, 2004-IX, § 52). Mirëpo, nuk mund të thuhet se ka ekzistuar ndonjë pritje legjitime kur ekziston kontesti lidhur me interpretimin dhe zbatimin e duhur të

[1] Në bazë të raportit përfundimtar të HPCC-së (Prishtinë, 2007, mund të gjendet në http://www.hpdkosovo.org/pdf/HPCC-Final_Report.pdf), 29160 kërkesa janë parashtruar në HPD (faqe 40).

ligjit vendor dhe kur parashtresat e ankuesit rrjedhimisht refuzohen nga gjykatat (GjEDNj (Dhoma e lartë), *Kopecky kundër Sllovakisë*, aktgjykimi i cituar më lartë, § 50; GjEDNj (Dhoma e lartë), *Anheuser-Busch* Inc. kundër Portugalisë, nr. 73049/01, aktgjykimi i datës 11 janar 2007, § 65).

94. Në këtë lëndë, HPPC-ja konstatoi se ankuesi nuk kishte dëshmuar se kishte fituar ndonjëherë posedimin e pronës në fjalë.

95. Kërkesa e ankuesit në thelb ka të bëjë me vërejtjet ndaj rregullsisë dhe rezultatit të procedurës para HPCC-së.
96. Nuk përjashtohet se UNMIK-u ka mundur të konsiderohet përgjegjës për efektet negative ndaj interesave pronësore të ankuesit, të cilat janë shkaktuar nga vendimi i HPCC-së, nëse ky vendim do të konsiderohej arbitrar apo në shikim të parë i paarsyeshëm (krahaso GjEDNj, *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, aktgjykimi i datës 22 gusht 2006, § 89; shih gjithashtu PKDNj, *Parliq*, nr. 01/07, Mendimi i datës 18 qershor 2010, § 49). Megjithatë, Paneli ka ardhur në përfundim se sipas nenit 6 § 1 të KEDNj-së (lidhur me seancën e drejtë dëgjimore), HPCC-ja ka dhënë arsye të mjaftueshme për vendimin e saj dhe se vlerësimi i elementeve i bërë nga HPCC-ja përkitazi me lëndën në fjalë nuk mund të konsiderohet si arbitrar (shih më lartë, §§ 64-77). Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se ankuesi nuk kishte "pritje legjitime", të bazuara në ligjin në fuqi, për të realizuar kërkesën e tij lidhur me posedimin e banesës.

97. Nga kjo del se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.

C. Shkelja e pohuar e nenit 8 të KEDNj-së

1. Argumentet e palëve

98. Ankuesi thotë se është penguar në qasjen dhe në riposedimin e shtëpisë së tij dhe nga të gëzuarit e lirë të hapësirës së tij private. Në këtë aspekt, ai thotë se termi "shtëpi", në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, i referohet jo vetëm vendit ku personi jeton, por edhe vendit ku personi ka qëllim për të jetuar. Ai ka dalë nga shtëpia e tij për shkak të rrethanave të jashtme, por kjo nuk nënkupton mosgatishmërinë e tij për t'u kthyer. Për më tepër, e drejta për respektimin e "jetës private" në kuptim të nenit 8 të KEDNj-së, nënkupton të drejtën në hapësirë personale apo private, e cila mund të shihet si e drejtë e personit të lihet i qetë dhe të gëzojë lirshëm hapësirën e tij private, pa ndërhyrje nga jashtë.

99. Në bazë të ankuesit, UNMIK-u kishte detyrë të mbronte të drejtën e tij për respektimin e shtëpisë dhe të jetës së tij private, por nuk ka vepruar në mënyrë të duhur. Ai veçanërisht thotë se UNMIK-u nuk ka krijuar një kornizë rregulluese, përmes së cilës do të sigurohej se procesi i vendimmarrjes i HPCC-së, që ka quar në masat e ndërhyrjes me të drejtat e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së, të jetë i drejtë dhe t'i kushtoj respekt të duhur interesave të mbrojtura me atë dispozitë.

100. Më tej, ankuesi thekson se garancitë për gjykim të drejtë në rastin e kërkesës së tij nuk janë respektuar si duhet gjatë procedurave në HPCC. Privimi i përhershëm për qasje në shtëpinë e tij përmes vendimit të paarsyeshëm përbën ndërhyrje në të drejtën e tij në shtëpi dhe në

jetën private, gjë e cila nuk mund të arsyetohet në bazë të paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNj-së.

101. PSSP-ja nuk jep komente specifike në këtë pjesë të ankesës.

2. Vlerësimi i Panelit

102. Paneli vëren se shkeljet e pohuara mbështeten në thëniet e ankuesit për shkeljen e pohuar të nenit 6 § 1 të KEDNj-së përkitazi me arsyetimin e vendimit të HPCC-së. Pasi që nuk gjeti shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (shih më lartë paragrafët 64-77), Paneli gjithashtu vjen në përfundim se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNj-së (shih PKDNj, *Vuçkoviq*, nr. 03/07, Mendimi i datës 13 mars 2010, § 59).

D. Shkelja e pohuar e nenit 13 të KEDNJ-së

1. Argumentet e palëve

103. Sipas nenit 13 të KEDNj-së, ankuesi i referohet faktit se i njëjti Panel i HPCC-së ka shqyrtuar ankesën dhe kërkesën e tij për rishqyrtim. Pasi që situata ka ndikuar në paanësinë e HPCC-së gjatë procedurave për rishqyrtim, ashtu siç thuhet nga ankuesi në bazë të nenit 6 § 1 të KEDNj-së, dhe pasi që nuk ka qenë i mundur rishikimi sipëror juridik i vendimeve të HPCC-së, procedurat për rishqyrtim nuk mund të shihen si në përputhje me standardet e "mjetit të efektshëm ligjor" sipas nenit 13 të KEDNj-së.

104. PSSP-ja nuk jep komente specifike në këtë pjesë të ankesës.

2. Vlerësimi i Panelit

105. Ankesa sipas nenit 13 të KEDNj-së duket të jetë e bazuar në elemente të njëjta, siç është edhe ankesa në bazë të nenit 6 § 1 të KEDNj-së lidhur me paanësinë e HPCC-së. Pasi erdhi në përfundim se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së në këtë aspekt (shih më lartë paragrafët 42-57), Paneli e konsideron të panevojshëm shqyrtimin e të njëjtës çështje ndaras në bazë të nenit 13 të KEDNj-së.

V. Rekomandimet

106. Paneli përkujton se ka gjetur se ankuesi nuk ka përfituar nga garancia e tribunalit të paanshëm gjatë procedurave për rishqyrtim para HPCC-së. Paneli nuk mund të spekulojë nëse rezultati i procedurës do të ishte tjetër nëse nuk do të kishte pasur shkelje të KEDNj-së. Kështu që nuk rekomandon ndonjë reparacion për dëme financiare.

107. Megjithëkëtë, mbetet fakti se procedura lidhur me kërkesën e ankuesit për rishqyrtim, sipas mendimit të Panelit, nuk janë mbajtur plotësisht në përputhje me KEDNj-në.

108. Paneli konsideron se pranimi nga UNMIK-u se shkelja ka ndodhur do të përbënte një formë të duhur të rregullimit për çfarëdo dëmi jofinanciar, të cilin ankuesi mund ta ketë përjetuar.

109. Sa i përket masave të përgjithshme që duhet të ndërmerren, Paneli rikujton se situata, e cila u gjet se nuk është në përputhje me nenin 6 § 1 të KEDNj-së, në ndërkohë është rregulluar nga UNMIK-u (shih më lartë, § 56). Sipas mendimit të Panelit, nuk nevojiten masa të tjera të natyrës së përgjithshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

1. **KONSTATON SE ANKESA E PËRGJITHSHME LIDHUR ME SHKELJEN E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME PAVARËSINË DHE PAANËSINË TË KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE-BANESORE NUK ËSHTË MBËSHTETUR ME PROVA;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME PAANËSINË E KOMISIONIT PËR KËRKESA PRONËSORE-BANESORE PËR SHKAK TË PËRBËRJES SË TIJ NË PROCEDURËN E RISHQYRTIMIT;**

3. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME DREJTËSINË E PROCEDURËS;**

4. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS;**

5. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

6. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

7. **KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA NË BAZË TË NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

8. **REKOMANDON QË NË EMËR TË UNMIK-UT, PËRFAQËSUESI SPECIAL I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË PRANOJ SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT, ASHTU SIÇ ËSHTË CEKUR NË PIKËN 2 MË LARTË.**

Rajesh TALWAR Paul LEMMENS

Zyrtar ekzekutiv Kryesues